



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 305 / 4 Prot

Tiranë, më 28 / 2 / 2022

VENDIM

Nr. 02, datë 28 . 2 . 2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 305 Prot., datë 07.02.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkuesit, ankuesi, nëpërmjet e-mail-it datë 13.01.2022, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni, në lidhje me:

- *Kopje e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar datë 06.05.2021, që ka lënë në fuqi vendimin e SPAK për mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasve Edi Rama, Erion Veliaj, Gjergj Bojaxhi, Dorian Matlija dhe Irena Dule të kallëzuar nga anëtarë të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, vendim i shpallur nga GJPAKKO më datë 18.10.2021.*

Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, me shkresën nr. 41 Prot., datë 21.01.2022, ka kthyer përgjigje duke cituar ndër të tjera se: “...Në rastin konkret nuk kërkohet një informacion publik ose një përmbledhje e vendimit gjyqësor sipas nenit 46/1/b të ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e

Shqipërisë”, por kopje e vendimit të Gjykatës, si akt i shqyrtimit gjyqësor, që ligjvënësi ka parashikuar se kompetente për shqyrtimin e të tillë kërkesë është “gjykata që ka dhënë vendimin”. Përsa parashikohet më lart, akti i shqyrtimit gjyqësor i kërkuar në format të plotë (kopje e vendimit), nuk bën pjesë në aktet e shqyrtimit gjyqësor publik, që të jepet për qëllim të nenit 11 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, qoftë edhe i kufizuar, por është shqyrtim i cili është zhvilluar në dhomë këshillimi, pra pa praninë e palëve apo të publikut. Së fundmi, evidentohet se kërkuesi nuk kërkon informacion në kuptim të nenit 2 dhe nuk kërkon as informacion të kufizuar sipas nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por një vendim gjyqësor (akt i shqyrtimit gjyqësor) në kuptim të nenit 112 të K.Pr.Penale, që kompetente për ta shqyrtuar është trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen. Pikërisht, sepse akti i shqyrtimit gjyqësor (marrë në dhomë këshillimi) i kërkuar nga kërkuesi, nuk hyn në kategorinë e informacionit publik, bazuar në nenet 1, 2, 7, 14 pika 4 dhe 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”: Refuzohet dhënia e aktit të shqyrtimit gjyqësor “Kopje të Vendimit për miratimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar datë 06.05.2021”, kërkuetit Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. Dorian Matlija”.

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se: “.... së pari: Informacioni i kërkuar është një informacion publik dhe bën pjesë në kategorinë e informacionit i cili vendoset në dispozicion pa kërkesë. Informacioni i kërkuar është një e dhënë e llojit vendim i cili disponohet nga Autoriteti Publik, si institucion i cili ka përpiluar informacionin e kërkuar. Së dyti: nuk kërkohet një akt i cili është akt i shqyrtimit gjyqësor, apo akt në fazën e hetimit, por vendimi përfundimtar i cili është dhënë nga gjykata, dhe si i tillë nuk i nënshtrohet dispozitave dhe kufizimeve të parashtruara nga ana e Autoritetit Publik. Përsa kohë është përfunduar procesi dhe është marrë një vendim përfundimtar, nuk jemi në fazën e hetimeve ku mund të pretendohet kufizimi i dhënies së një akti. Vendimi objekt i kërkesës është një vendim i cili është marrë në bazë të nenit 291 të K.Pr.Penale “Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së akteve...” dhe jo gjatë një gjykimi me dyer të mbyllura, sipas nenit 340 të K.Pr.Penale, i cili rregullon rastet specifike me dyer të mbyllura. Pra vendimi i kërkuar është një vendim përfundimtar, i cili bën pjesë në kategorinë e informacioneve publike sipas nenit 2 pika 2 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe si i tillë duhet vënë në dispozicion nga Autoriteti Publik”.

Në këto kushte, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 305/1 Prot., datë 10.02.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe rivlerësimin e dhënies së dokumentacionit të kërkuar në përputhje me dispozitat e cituara.

Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik me shkresën nr. 98/1 Prot., datë 17.02.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 305/2 Prot., 18.02.2022, ka rikonfirmuar qëndrimin duke sqaruar edhe njëherë se: “*...Në përballje të kërkesës për t’u pajisur me akt të shqyrtimit gjyqësor, si vendimi penal i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pra i marrë nga Gjykata e Posaçme e Apelit në përfundim të shqyrtimit të ankimit në dhomë këshillimi (pra jo publik), me parashikimin ligjor të nenit 105 të K.Pr.Penale, i cili në mënyrë eksplicite thotë se: “1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive. 2.Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor. 3.Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit”*, konkludoi koordinatori për të drejtën e informimit, se forma e kërkesës nuk përputhet me dispozitat e LDI.

Në të tjera terma, sipas nenit 1 të LDI, koordinatori për të drejtën e informimit trajton kërkesat që lidhen me të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, të cilat kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.

Në rastin konkret kërkuesi nuk ka kërkuar një informacion publik ose një përmbledhje të vendimit gjyqësor por kopje të vendimit të Gjykatës, si akt i shqyrtimit gjyqësor (neni 112 i K.Pr.Penale “Format e disponimit të gjykatës”), proceduar nga gjykata në dhomë këshillimi (neni 291/5 i K.Pr.Penale), që ligjvënësi ka parashikuar se, së pari, vendimet e marra nga gjyqtari i hetimeve paraprake (neni 291/3 i K.Pr.Penale), në dhomë këshillimi nuk janë publike dhe së dyti, kompetente për shqyrtimin e të tillë kërkesë është “gjykata që ka dhënë vendimin” (neni 105 i K.Pr.Penale).

Gjithashtu, referuar faktit se bëhet fjalë për akt të shqyrtimit gjyqësor të marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi - dhe jo gjykim themeli që të procedohet nga gjykata sipas nenit 340 të K.Pr.Penale (siç dhe kërkuesi pretendon), - dhe faktit se rasti parashikohet nga ligjvënësi i tillë që shqyrtohet nga gjyqtari që shqyrton ankesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, që në çdo rast janë pa pjesëmarrjen e publikut, ka mbajtur parasysh koordinatori për të drejtën e informimit, përveç sa parashikon LDI, edhe nenin 103 të K.Pr.Penale, i cili në mënyrë eksplicite parashikon ndalimin se: “1. Ndalohet publikimi, goftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. 2. Ndalohet publikimi, goftë edhe i piesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. 3.Ndalohet

publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë. 4. Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç”.

Po ashtu, ka mbajtur parasysh edhe nenin 104 të K.Pr.Penale me përshkrimin:

“1. Shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose i një enti publik, kur nuk përbën vepër penale, është shkelje disiplinore. Në këtë rast prokurori njofton organin që ka të drejtë të marrë masa disiplinore.”

Përsa parashikohet më lart, akti i shqyrtimit gjyqësor i kërkuar nga kërkuesi në format të plotë, (vendimi i arsyetuar), nuk bën pjesë në aktet publike, që të jepet për qëllim të nenit 11 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” qoftë edhe i kufizuar, por është akt i shqyrtimit gjyqësor i marrë në dhomë këshillimi, pra pa praninë e palëve apo të publikut, dhe si i tillë trajtohet sipas procedurës së nenit 105 të K.Pr.Penale (nga gjyqtari që ka dhënë vendimin).

Nga ana tjetër, kërkuesit nuk i është mohuar e drejta e aksesit për të marrë informacion - për më tepër që në rastin konkret nuk ka kërkuar informacion - por i është treguar saktësisht rruga që duhet të ndjekë për të kërkuar si person i interesuar një akt të shqyrtimit gjyqësor, si kopje e vendimit të arsyetuar, që në mënyrë eksplicite parashikohet nga neni 105 i K.Pr.Penale.

Në konsideratë dhe të faktit se, shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose i një enti publik, kur nuk përbën vepër penale, është shkelje disiplinore, pikërisht për të mos bërë qoftë dhe shkelje disiplinore, koordinatori për të drejtën e informimit, brenda afatit të parashikuar nga ligji, ka marrë vendimin për refuzimin e dhënies së aktit të kërkuar.

Për sa më sipër, bazuar në ligjin e brendshëm dhe duke vërejtur se Rekomandimi CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 17 nëntor 2010 në mbledhjen e 1098-të të Deputetëve të Ministrave), në mënyrë eksplicite parashikon në pikën 19 se “Procedurat dhe çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë janë me interes publik. Megjithatë, e drejta për informim në lidhje me çështjet gjyqësore duhet të ushtrohet duke pasur parasysh kufizimet e imponuara nga pavarësia e gjyqësorit. Zëdhënësit e gjykatave ose themelimi i shërbimeve të shtypit dhe të komunikimit janë në përgjegjësinë e gjykatave ose nën këshillat gjyqësorë apo nën autoritete të tjera të pavarura është i inkurajuar. Gjyqtarët duhet të jenë të përmbajtur në marrëdhëniet e tyre me mediat”, koordinatori për të drejtën e informimit e ka drejtuar kërkuesin që sipas ligjit dhe si person i interesuar t’i drejtohet gjykatës (trupit gjyqësor) që ka shqyrtuar çështjen”.

Në vijim, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon

një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenet 41,64,77 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore me Autoritetin Publik.

Seanca u zhvillua me datë 24.02.2022 me prezencën e koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik dhe në mungesë të ankuesit, i cili me e-mail-in datë 23.02.2022, bëri me dije se për shkak të COVID 19, personi përgjegjës për të drejtën e informimit nuk mund të ishte prezent. Në këto kushte i qëndroi ankimit të depozituar pranë Zyrës së Komisionerit. Ndërkohë, Autoriteti Publik rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik në shkresën nr. 98/1 Prot., datë 17.02.2022, konfirmuar dhe gjatë seancës dëgjimore, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI, detyrimet që burojnë nga ky i fundit dhe me dispozitat e ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit:

“Neni 8 - “Parimet e shërbimit civil gjyqësor 1. Veprimtaria e shërbimit civil gjyqësor rregullohet me ligj dhe bazohet mbi parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve eficiente dhe të aksesueshme për çdo person..”... Neni 46 “Marrëdhëniet me publikun 1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që:

- a) t’i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara;*
 - b) t’i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;*
 - c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik;*
 - ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore;*
 - d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.*
- 2. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë”.*

Ndërkohë, në nenin 2 të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për

rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Gjatë seancës dëgjimore apo shkresave zyrtare, Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment se është përpara kufizimeve të nenit 17 të LDI, në të cilin parashikohen rastet e kufizimit të së drejtës për informim, nga zbatimi i të cilit nuk përjashtohet as Autoriteti Publik objekt i këtij vendimi dhe as procesi i kryerjes së hetimeve në lidhje me ndjekjen e veprave penale.

Konkretisht, në pikën 2 të nenit 17 të LDI parashikohet se: *“E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale..... Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e parë, të pikës 2, të këtij neni, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij”.*

Referuar parashikimit të mësipërm, rezulton qartësisht se LDI nuk përjashton nga fusha e veprimtarisë së tij procesin e parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale. Për më tepër, për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij: Neni 1 *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*, ka parashikuar dhe rastin se nëse kërkohet informacion në kuadër të parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale, ky informacioni nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Ndërkohë, në pikën 6 të nenit 17 parashikohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim.”.*

Bazuar në sa më sipër, rezulton se Autoriteti Publik nuk ka vepruar në përputhje me pikën 2 dhe 6 të nenit 17 të LDI.

Gjithashtu, neni 105 i ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “K.Pr.Penale”), të cilit i referohet Autoriteti Publik, nuk kufizon dhënien e informacionit të kërkuar, pasi në pikën 1 të tij parashikon se gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive.

Më tej, Autoriteti Publik arsyeton se vendimi objekt ankese, nuk duhet të vihet në dispozicion të kërkuesit sipas kërkesës së tij, pasi dhënia dhe publikimi i tij është i ndaluar me ligj, duke referuar nenin 103 të K.Pr.Penale, *“Ndalimi i publikimit të aktit”*, i cili parashikon se:

“1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv.

2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake.

3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë., si dhe në nenin 104 “Shkelja e ndalimit të publikimit” i cili parashikon se:
1. Shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose i një entit publik, kur nuk përbën vepër penale, është shkelje disiplinore. Në këtë rast prokurori njofton organin që ka të drejtë të marrë masa disiplinore”.

Gjithashtu, Autoriteti Publik refuzon vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar bazuar në argumentat se publikimi është i ndaluar pasi gjykimi për marrjen e këtij vendimi është bërë me dyer të mbyllura.

Nga sa më sipër, konstatohet se, qëndrimi dhe argumentat e parashtuar nga Autoriteti Publik kanë lidhje me procedurën që duhet të ndiqet nga ky i fundit, në kuadër të ushtrimit të detyrave funksionale në përputhje me ligjin organik, të cilat nuk krijojnë konflikt me dispozitat e LDI.

Komisioneri vlerëson se argumenti për ndalimin e publikimit bazuar në pikën 2 të nenit 103 të K.Pr.Penale, nuk gjen zbatim, pasi bazuar dhe në sqarimet e Autoritetit Publik, vendimi objekt kërkimi është marrë në dhomë këshillimi në përputhje me nenin 329/ç të K.Pr.Penale “Ankimi ndaj vendimit”, Kundër vendimit të mospranimit ose të rrëzimit të kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit, prokurori, viktima ose trashëgimtarët e saj, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, e cila shqyrton ankimin në dhomë këshillimi, dhe jo gjatë një gjykimi me dyer të mbyllura, sipas nenit 340 të K.Pr.Penale, i cili rregullon rastet specifike të gjykimit me dyer të mbyllura.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuesit çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI si dhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, i cili në nenin 2 të tij parashikon se “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.”, ndërsa në pikën 1 të nenit 27 parashikon: “Masat për sigurinë e të dhënave personale 1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.”.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me qëllim përpunimin dhe publikimin e ligjshëm të të dhënave personale në sistemin gjyqësor, Autoriteti Publik duhet të mbajë në konsideratë rregullimin e posaçëm, sipas Udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i cili në Kreun IV parashikon se: “1. Të dhënat personale ose sensitive që përmban vendimi gjyqësor, bëhen publike vetëm nëse nga ky publikim nuk cenohen interesat legjitimë të subjekteve të të dhënave. 2. Subjekti i të dhënave personale informohet mbi të dhënat e tij, të cilat do të publikohen me iniciale ose të koduara në faqen zyrtare në internet sipas këtij udhëzimi, me qëllim bërjen e tij të paidentifikueshëm. 3. Përpara publikimit dhe vënies në dispozicion të publikut, personat përgjegjës kujdesen për të siguruar që të dhënat personale në vendimet gjyqësore të jenë të sakta dhe të plota. Nëse verifikohet se të dhënat personale në vendimet gjyqësore të papublikuara janë të pasakta ose të paplota, për korrigjimin apo fshirjen e tyre, personi përgjegjës konsultohet me gjyqtarin e çështjes. Pas këtij konsultimi, korrigjimi, fshirja apo bllokimi kryhet në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. 4. Personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale, vendimeve civile (të cilat janë dhënë mbi kërkesëpadi) në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregullat e mëposhtëm, në mbrojtje të privatësisë: a) Gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim, paraqiten me iniciale ose kodohen. b) Në pjesën arsyetuese të vendimit, ndalohet publikimi i të dhënave personale që cenojnë privatësinë e palëve në gjykim (si p.sh: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave).7. Në të gjitha rastet kur palët në gjykim janë minorene, ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe të dhënave të tjera identifikuese (personale) ose të dhënave lidhur me të tretë, nga të cilat mund të zbulohet edhe indirekt, identiteti i minorinit.”

Në lidhje me pretendimin e moslegjitimitetit të kërkuarit, Komisioneri thekson se LDI nuk kushtëzon dhënien e informacionit/dokumentacionit të konsideruar publik me paraqitjen nga ana e kërkuarit të arsyeve apo interesit që ka në marrjen e këtij informacioni. Për më tepër, kërkuari/ankuesi është një organizatë jo-fitimprurëse, që ka për qëllim kryesor promovimin e medias të lirë dhe të pavarur, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me korrupsionin, pandëshkueshmërinë, situatën e të drejtave të njeriut, si dhe aktivitetin e shoqërisë civile në Shqipëri, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*¹, ka marrë në analizë legjitimitetin e organizatës jofitimprurëse në kërkimin e informacionit nga autoriteti publik si dhe natyrën e këtij informacioni, nëse përbën apo jo një informacion me interes për publikun. Në këtë çështje Gjykata është shprehur se: “27. ...aplikanti është një organizatë/shoqatë e përfshirë në çështje gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut

¹ Vendim i GJEDNJ në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë* (me numër aplikimi 37374/05, datë 14.04.2009)

me objekt nga më të ndryshmet, duke përfshirë këtu dhe të drejtën e informimit. Prandaj mund të karakterizohet ashtu sikundër media si një “vëzhgues shoqëror”. ...28. Në rastin konkret vihej në diskutim kushtetushmëria e ligjit penal në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, paraqitja e një kërkesë për rishikimin e kushtetutshmërisë së ligjit penal, veçanërisht nga një Anëtar i Parlamentit, pa dyshim që përbënte një çështje me interes publik. Si pasojë, Gjykata konstaton se kërkuesi në rastin konkret ka kërkuar informacion për një çështje me rëndësi publike... Për më tepër, duke pasur parasysh se qëllimi i aplikantit ishte të jepte tek publiku informacionin e mbledhur nga kërkesa e paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese dhe në këtë mënyrë të kontribuonte në debatin publik në lidhje me legjislacionin për veprat penale në fushën e narkotikëve...”

Gjithashtu, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në rastin konkret, Komisioneri vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë dhe vet qëllimi në tërësi i reformës në drejtësi dhe sistemin gjyqësor, i cili synon garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisht së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, nëpërmjet transparencës së veprimtarisë së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 305 Prot., datë 13.01.2022, nga Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. Dorian Matlija, kundër Autoritetit Publik “Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 13.01.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje

me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe anonimizimin sipas udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, konkretisht: *(Kopje e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar datë 06.05.2021, që ka lënë në fuqi vendimin e SPAK për mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasve*

të kallëzuar nga anëtarë të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, vendim i shpallur nga GJPAKKO më datë 18.10.2021.), brenda datës 07. 3.2022.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 28. 2.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

